



PROCESVERBALI

Vazhdimi i mbledhjes Plenare për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, e mbajtur më **20.01.2018** me fillim në ora **22.30**. Mbledhjen e kryesoi kuvendari më i vjetër i Kuvendit z. **Bajram Morina**. Në sallë janë të pranishëm 17 Kuvendarë.

Bajram Morina – Fillimisht më lejon të përshëndes Kryetarin e Komunës z. Smajl Latifin, stafin e tij ekzekutiv, delegatët e kuvendit komunal, përfaqësuesit e LMT-së, mediave, OSBE-së dhe gjithë ju të pranishëm, mirë se keni ardhur. Për këtë Mbledhje është paraparë:

1. Vazhdimi i Mbledhjes për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Kryesuesi Morina - Në mbështetje të nenit 44 paragrafi 44.6 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02\2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit Komunal, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit thërrasin mbledhjen urgjente me datë **20 janar 2018 (Shtune), me fillim në ora 20:00**, pas mbledhjes së 11 nënshkrimeve, me të vetmen pikë të rendit të ditës, vazhdimin e seancës për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit. Anëtarët e komisionit për mbikëqyrje të mbarëvajtjes së procesit të votimit që kanë qenë të zgjedhur me datë 19.01.2018, janë: z. Ali Morina, z. Faton Ramadani dhe z. Astrit Thaqi, në mungesë të anëtarit të Komisionit z. Astrit Thaqi, jemi të obliguar që të bëjmë zëvendësim me një anëtar të ri të komisionit. Ka dikush ndonjë propozim:

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Ne si grup i LVV-së propozojmë për anëtare të Komisionit znj. Vjosa Isma.

Kryesuesi Morina – E qesim në votim propozimin e LVV-së: Konstatoj se në mënyrë unanime është votuar që znj. Vjosa Isma të jetë anëtare e Komisionit për Mbikëqyrjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit. Siq e dini nga Mbledhja e mbajtur dje për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Pas rrethit të parë të votimit kandidatë në rrethin e dytë të votimit sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 Për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, shkojnë në votim z. Sali Sallteku nga radhët e PDK-së si dhe z. Afrim Dina nga radhët e AAK-së. Së pari i lutem anëtarëve të komisionit që të dalin që të bëjnë vëzhgimin e procedurës së votimit, do filloj të i thërras me radhë emrat sipas listës, ata të cilët janë prezent do vinë do e nënshkruajnë listën për pjesëmarrje për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, pastaj do e marrin fletën e votimit tek z. Skender Hamza dhe do votojnë. Nga 31 kuvendarë sa i ka Kuvendi i Komunës së Rahovecit, 17 kanë qenë prezent në votimin e Kryesuesit, 3 kanë abstenuar. Ftojme Komisionin për mbikëqyrjen e votimit që të bëjë verifikimin dhe numërimin e votave në kuti dhe të na japin rezultatet.

Ali Morina – Kryesues i Komisionit, Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, komisioni për verifikimin e procesit të votimit ka bërë gjithë numërimin e listave të votimit dhe ka dalë me këto rezultate, nënshkrimet në listën për pjesëmarrje të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit janë 14, në kuti po ashtu janë 14 fletëvotime, 3 anëtarë kanë abstenuar në votim dhe sipas komisionit gjithçka përputhet dhe është në rregull. Rezultati i votimit është ky : Kandidati nga radhët e PDK-së z. Sali Sallteku ka marrë 1 (një) votë, kurse kandidati nga radhët e AAK-së z. Afrim Dina ka marrë 13 (trembëdhjetë) vota. Komisioni konstaton se as në raundin e dytë nuk është zgjedhur Kryesuesi i Komunës së Rahovecit, prandaj duhet që të përsëritet edhe një rreth i votimit, rrethi i tretë.

Kryesuesi Morina – Ftojme z. Skender Hamza zyrtarin e Sekretarisë së Kuvendit që të bëjë verifikimin se a kemi kuorum për rrethin e tretë të votimit. Sipas sekretarisë së Kuvendit kemi kuorum për të shkuar në rrethin e

tretë të votimit, prezent në sallë janë 17 anëtarë të Kuvendit të Komunës. E ftojë prapë komisionin për verifikimin e procesit të votimit që të dele të përcjellë votimin. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 Për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, në rrethin e tretë kandidati i cili merë një votë më shumë se kundër kandidati do të zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës. Ashtu si në rrethin e parë dhe të dytë prapë edhe në rrethin e tretë do ti ftojme me emër një nga një anëtarët e kuvendit. Nga 31 kuvendarë sa i ka Kuvendi i Komunës së Rahovecit, 17 kanë qenë prezent në votimin e Kryesuesit, 3 kanë abstenuar. Ftojme Komisionin për mbikëqyrjen e votimit që të bëjë verifikimin dhe numërimin e votave në kuti dhe të na japin rezultatet.

Ali Morina – Kryesues i Komisionit, mbas rrethit të tretë të votimit, komisioni ka konstatuar se në listën e nënshkrimeve për pjesëmarrje të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit kanë qenë 14 nënshkrime, 3 kanë abstenuar, po ashtu në kutin e votimit kanë qenë 14 fletëvotime, komisioni konstaton se rezultati i rrethit të tretë të votimit është ky: Kandidati i nga radhët e PDK-së z. Sali Sallteku ka marrë 0 (zero) vota, kurse kandidati nga radhët e AAK-së z. Afrim Dina ka marrë 14 (katërmëdhjetë) vota, komisioni konstaton se sipas këtij rezultati z. Afrim Dina është zgjedhur Kryesues i Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi Morina – E ftojme të zgjedhurin për Kryesues të Kuvendit z. Afrim Dina që të japë betimin para Kuvendarëve.

Afrim Dina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Unë, AFRIM DINA, “betohem se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesi Morina – Ftojë Kryesuesin e sapo zgjedhur z. Afrim Dina që ti përshëndet të pranishmit me një fjalë rasti.

Kryesuesi Dina - Të nderuar të pranishëm më lejoni të përshëndes Kryetarin e Komunës z. Smajl Latifin, udhëheqësin e Mbledhjes së sotme z. Bajram Morinën, juve kuvendarëve, mediat, OSBE-në dhe gjithë të pranishmit. Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit i falënderoj për besimin që më kanë dhënë për udhëheqjen e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për 4 (katër) vite, si Kryesues i Kuvendit të Komunës do të respektoj fjalën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës, besoj shumë në bashkëpunimin e të gjithëve në mënyrë që qytetarëve tonë ti i mundësojmë një zhvillim sa më mirë ekonomik, edhe një herë faleminderit dhe suksese të gjithëve në punë.

Udhëheqësi i Mbledhjes - Ftojë Kryesuesin e Komunës z. Afrim Dina që të vije të ulet tek vendi që i takon, ju faleminderit të gjithëve.

Kryesuesi Dina – Të nderuar Kuvendarë meqë nuk kemi për sot ndonjë pikë tjetër, me kaq e mbyllim mbledhjen e sodit, shihemi në mbledhjet e radhës, natën e mirë.

Mbledhja përfundoi në ora 23.10

Procesmbajtësi

Skender Hamza

Kryesues i Mbledhjes

Bajram Morina